



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.04.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrër, (çështje e shtyrë nga mbledhja plenare të datës 19.03.2024, 09.04.2024).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:15 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
- 6. {...}, Inspektore jomagjistrate pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në sallë).*
- 7. {...}, Inspektor magistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në sallë).*
- 8. {...}, Këshilltare për komunikimin dhe median në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- 9. {...}, gjyqtar (në sallë).*
- 10. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, (çështje e shtyrë nga mbledhja plenare të datës 19.03.2024, 09.04.2024).

Mbledhja çelet nën drejtimin e z. Rusi, në cilësinë e zëvendëskryetarit, me pjesëmarrje

vetëm të anëtarëve të Këshillit. Kryetarja e Këshillit për arsye të angazhimeve institucionale e ka të pamundur të jetë prezent.

(Pas vendimmarrjes nga ana e anëtarëve, mundësohet lidhja nëpërmjet platformës online, si dhe ftohen përfaqësuesit e ILD-së dhe gjyqtari z. Dosti të jenë të pranishëm në sallë për t'i komunikuar vendimmarrjen.

Futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së, znj. Tafani, z. Zonja si dhe magjistrati z. Dosti.)

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Prezent janë përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrati z. Dosti.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në vijim të këtij procedimi disiplinor, në lidhje me procedimin disiplinor nr. 4/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyrokastër, referuar bazës ligjore përkatëse, vendosi:

Rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese, afat i cili fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet subjekteve të procedimit, magjistratit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.04.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:15 dhe mbaroi në orën 13:33.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. ***Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.***
2. ***Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***
3. ***Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***
4. ***Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.***
5. ***Staf nga administrata e KLGJ-së.***

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 2 të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Relacioni i radhës ka për objekt caktimin e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Deri më datë 18.04.2024, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas të

dhënave të më poshtme. Bëhet fjalë për një çështje penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion, nr. i kërkesës 497.). Kërkohet caktimi i një gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues gjykimin e çështjes penale me të pandehur {...} etj. Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët: {...} dhe {...}; Kanë pengesë për të gjykuar çështjen e mësipërme gjyqtarët: {...} dhe {...}, pasi kanë qenë gjyqtarë të hetimeve paraprake; Gjyqtarët {...} dhe {...} kanë qenë gjyqtarë të themelit ndaj të bashkëpandehurve të tjerë në këtë procedim; Gjyqtare {...} ka qenë gjyqtare e themelit në gjykimin në shkallë të parë; gjyqtarët {...} dhe {...} u është pranuar kërkesa për heqje dorë pasi kanë gjykuar të bashkëpandehurit; kanë pengesë gjithashtu edhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, {...} dhe {...}.

Zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit dhe zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit në këtë rast bëhen të pamundura për t'u aplikuar, kështu që ndodhur në këto kushte, Komisioni propozon të vihet në zbatim mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Propozimi mbështetet në paragrafin X/2 të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, por edhe referuar përcaktimeve të shkronjës “c”, pika 5, Kreu IV, të këtij Vendimi, dhe në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të vendimit të cituar më lart. Ndaj Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, të përzgjidhet me short 1 i tillë, ndërmjet gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart.

Përfshijet nga shorti:

Referuar paragrafit VIII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit më sipër: z. {...}, z. {...}, gjithashtu edhe zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm znj. {...}. Në këtë rast i bëj thirrje teknikës që të përjashtohen gjyqtarët e përmendur më lart: z. {...}, znj. {...} dhe {...}.

Këto janë propozimet. Lista e gjyqtarëve është bashkëlidhur relacionit përkatës kështu që jemi gati për t’iu përgjigjur ndonjë pyetjeje apo ndonjë komenti që kanë kolegët lidhur me relacionin e përgatitur. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Anëtarët e Këshillit nuk kanë komente apo kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik, duke u bërë më parë përditësimi i listës së gjyqtarëve të cilët do përfshihen në këtë short sipas mekanizmit përkatës.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën 497, gjyqtar i përzgjedhur z. Fatri Islamaj.

Ilir Rusi: Me hedhjen e këtij shorti u shqyrtuan të dyja pikat që ishin pjesë e këtij rendi të ditës. Gjithashtu e theksoj edhe në fund të mbledhjes që përpara se të fillonte për publikun kjo mbledhje, ka pasur diskutime të gjata për shkak të natyrës së çështjeve që ishte pjesë e kësaj mbledhjeje dhe kjo ishte arsyeja pse mbledhja filloi në atë orë.

Pasdite të qetë!

Faleminderit!

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor